



Në bazë të Nenit 50 paragrafi 1 pika 9 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 05/02), dhe në lidhje me Nenin 29 paragrafi 3 të Ligjit për Kulturë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 31/98, 49/03, 82/05, 24/07, 116/10, 47/11, 51/11, 136/12, 23/13, 187/13, 44/14, 61/15, 154/15, 39/16, 11/18 dhe 11/18) dhe në përputhje me Nenin 45 paragrafi 3 të Ligjit për Institucionet (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 32/05; 120/05, 51/11) dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 99/22) dhe Nenit 26 dhe 27 të Statutit të Institucionit Publik “Kopshti Zoologjik” – Shkup, (nr. 01-107 të datës 16.05.2006, 01-107/2 të datës 26.12.2011, 02-90/2 të datës 16.03.2012, 01-64/2 të datës 23.02.2018, 01-134/2 të datës 19.03.2019 dhe 01-190/2 të datës 23.04.2019), Kryetarja e Qytetit të Shkupit shpall

SHPALLJE PUBLIKE
për zgjedhjen e drejtorit të Institucionit Publik
“Kopshti Zoologjik” – Shkup

1. Kandidati duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- në momentin e zgjedhjes me vendim gjyqësor të formës së prerë të mos i jetë shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtjeje për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë apo detyrës;
- të ketë fituar më së paku 240 kredi sipas EKTS ose të ketë përfunduar shkallën VII/1të arsimit të lartë;
- të ketë minimum pesë vjet stazh pune në fushën e kulturës ose pesë vjet eksperiencë pune në punë ose projekte në fushën e kulturës në bazë të kontratave të lidhura për punë;
- të ketë një nga certifikatat e mëposhtme të njohura ndërkombëtarisht ose vërtetime për njohjen aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:
 - TOEFEL IBT - më së paku 74 pikë,
 - IELTS - më së paku 6 pikë,
 - ILEC (Cambridge English: Legal) - më së paku nivel B2,
 - FCE (Cambridge English: First) – të përfunduar
 - BULATS - më së paku 60 pikë ose
 - APTIS - më së paku nivel B2

2. Kandidati është i obliguar që përveç dëshmive për plotësimin e kushteve të lartpërmendura të depozitojë edhe dokumentet e mëposhtme:

- Fletëparaqitje me biografi të shkurtër dhe
- Propozim-Program për punën dhe zhvillimin e institucionit

3. Dokumentacionin e nevojshëm kandidati është i obliguar ta depozitojë në origjinal ose kopje të noterizuar.
4. Afati për depozitim të dokumentacionit të nevojshëm është 15 ditë pune nga dita e shpalljes së Shpalljes publike në shtypin e ditës.
5. Dokumentacioni i depozituar jashtë afatit të caktuar, i pakompletuar dhe i parregullt nuk do të jetë lëndë e shqyrtimit. Fletëparaqitjet për Thirrjen publike depozitohen në adresën e mëposhtme:

**Institucioni Publik “Kopshti Zoologjik” - Shkup
Këshilli Drejtues
(për Shpalljen publike për zgjedhjen e drejtorit)
Adresa e institucionit: bul.”Ilinden” nr. 88
1000 Shkup**

**Qyteti i Shkupit
Kryetarja**

Danela Arsovska

